



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 71 datë 31-07-2025

**PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS TË MBLEDHJES
SË DATËS 31 KORRIK 2025 TË KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi shqyrtoi me këshilltarët dhe miratoi propozimet e paraqitura si dhe pikat e rendit të ditës të njoftuara për vendimarrje në njoftimin për mbledhjen e datës 23.07.2025, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, pika 5 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 55 pika 3, pika 4 shkronja (a) e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr.80, datë 30.07.2020.

V E N D O S I;

1. Të miratojë rendin e ditës për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Korçë sipas njoftimit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratuar me 24 vota

Vota Pro 24

Vota Kundër 1

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 31-07-2025





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

BASHKIA KORÇË

NR 7184 PROT-
DATA 23/07/2025

Korçë më 23.7.2025

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Këshilltarëve të Këshillit Bashkiak Korçë

Kryetarit të Bashkisë Korçë z.Sotirag Filo

Njoftohen të gjithë këshilltarët e Këshillit Bashkiak Korçë dhe Kryetari i Bashkisë Korçë z.Sotirag Filo, se ditën e Enjte , datë 31 korrik 2025, ora 12⁰⁰ do të zhvillohet mbledhja e Këshillit në sallën e Këshillit Bashkiak, në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53,pika 4 si dhe bazuar në Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr.80, datë 30.07.2020 , neni 63, neni 64 me rend dite si më poshtë:

- 1- "PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS".
- 2- "PËR MIRATIMIN E DORËHEQJES SË KËSHILLTARES ISEMRALDA SEIDOLLI.
- 3- "PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 26 QERSHOR 2025 DHE MBLEDHJES SË DATËS 21 KORRIK 2025".
- 4- "MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR PERIUDHËN 1-30 QERSHOR 2025".

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore,
Mosdiskriminimit, të Drejtave të Njeriut) znj.Anxhela Taho , znj.Edlira Mitre ,
znj.Ornela Alikaj, z.Erjon Kurti, znj.Jorida Romaçka, z.Lorenc Nako,
znj.Laureta Alidinaj.

- 5- “PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028 NË NIVEL PROGRAMI.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj. Ada Përmeti
z. Petrika Tollkuçi, z. Devis Osman, znj. Alketa Zheku.

- 6- “PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE NGA TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE NË VLERËN 243,812.5 LEKË DHE KRYERJEN E PAGESËS PËR KTHIMIN E SHUMËS NË PO KËTË VLERË PËR LLOGARI TË “TELEKOM ALBANIA” SH.A,(ONE TELECOMMUNICATIONS).

(Komisioni Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj. Ada Përmeti
z. Petrika Tollkuçi, z. Devis Osman, znj. Alketa Zheku.

- 7- PIKA TË NDRYSHME.

- 8- KËRKESA-ANKESA TË QYTETARËVE.

Mbledhjet e komisioneve do të zhvillohen ditën e hënë , datë 28.07.2025, ora 11⁰⁰

Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj. Ada Përmeti
z. Petrika Tollkuçi, z. Devis Osman, znj. Alketa Zheku ditën e hënë 28.07.2025, ora 12⁰⁰

Komisionet do të zhvillojnë mbledhjet në sallën e Këshillit Bashkiak.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Ana VERUSHI

